

5. Investim i zgjuar dhe me kthim të shpejtë

Green Coast Resort nuk është vetëm shtëpia e ëndrrave apo vendi ideal për pushime, por është gjithashtu edhe një blerje e zgjuar për investim. Bazuar në eksperiencat e suksesshme europiane, Green Coast po sjell koncepte risi të manaxhimit dhe qiradhënies, të tilla si "Programit të Qiradhënies" dhe "Time Sharing". Pjesë e këtyre programeve mund të bëhet cilido që investon në Green Coast Resort, duke zgjedhur prona sipas tipologjive, sipërfaqeve dhe vlerës.

"Programi i Qiradhënies" ju kthen investimin duke filluar nga 13 vite!

Nëpërmjet "Programit të Qiradhënies", pronari i vilës apo apartamentit mund ta japë me qira njësinë e tij në atë periudhë të vitit që ai dëshiron. Kjo marrëdhënie rregullohet nëpërmjet një kontrate e cila lidhet midis pronarit dhe zyrave të administrimit të Green Coast, ku Green Coast bëhet përgjegjës për gjetjen e klientëve të interesuar për qira.

Konceptimi dhe zhvillimi i resortit bën të mundur shndërrimin e zonës së Palasës nga një destinacion turistik veror, në një destinacion të frekuentuar gjatë gjithë vitit. Kjo siguron që prona juaj të përdoret në një periudhë më të gjatë të vitit, duke sjellë një kthim më të lartë dhe më të shpejtë të investimit.

"Time Sharing" një tjetër koncept risi, është investim në bashkëpronësi ku dy ose më shumë persona mund të blejnë një pronë, duke investuar në përqindje të ndryshme pagese. Në bazë të kësaj kuote ndahen të drejtat dhe detyrimet mes bashkëpronarëve, përfshirë këtu edhe përfitimet e pronësisë me dokumentacion të rregullt.

6. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pronës

Menaxhimi i resortit, një shërbim me nivel të lartë në standard me 5 yje, do të sigurojë bashkëjetesë të qetë dhe të sigurt falë sistemit të monitorimit me roje private dhe kamera 24 orë/7 ditë të javës, mirëmbajtjes dhe pastrimit të ambienteve të përbashkëta të pronës suaj. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e resortit do të bëhet nga një kompani e konsoliduar dhe me eksperiencë të gjatë në tregun shqiptar.

7. Shërbime ekstra dhe çmime preferenciale për klientët


Pjesë e këtij projekti është shëtitortja me njësi biznesi, të tilla si: bare, restorante, beach-bare, supermarket, qendër sportive, amfiteatër, etj. Shëtitortja do të jetë në funksion të banorëve dhe vizitorëve duke shërbyer si qendër argëtimi dhe relaksi.

Gjithashtu, pjesë e Green Coast Resort do të jetë edhe Hoteli me 5 yje, operuar nga një prej markave më të njohura botërore, i cili do të sjellë një standard të lartë në strukturat akomoduese të turizmit bregdetar elitare në Shqipëri.

"Buttler Service" është një tjetër risi e sjellë në Green Coast, ku çdo banor do të ketë mundësinë të përfitojë shërbim të personalizuar sipas nevojës.



SHËRBIME UNIKE DHE TË DEDIKUARA



GREEN COAST

PERLA E PAZBULUAR E MËSDHEUT

Palasë, Shqipëri
www.greencoast.al
sales@greencoast.al
+355 69 8014999

GREEN COAST
PERLA E PAZBULUAR E MËSDHEUT

Udhëzuesi juaj për të blerë një pronë në

GREEN COAST RESORT

TANI

Është koha ideale për të blerë një vilë në GREEN COAST RESORT

E bekuar me detin e kaltër, gjelbërimin e natyrës, florën dhe faunën e pasur, Palasa është cilësuar si një nga perlat e rivierës shqiptare jo vetëm nga mediat vendase, por edhe nga ato ndërkombëtare. Me një histori që nga koha e Jul Çezarit dhe kulturë të hershme, zona trashëgon mikpritjen, bujarinë, kuzhinën tipike mesdhetare si vlera të çmuara të Shqipërisë.

Në këtë zonë është duke u ndërtuar Green Coast Resort, më i madhi në Shqipëri dhe një ndër më të mëdhenjtë në Ballkan.

Resorti Green Coast është i përbërë nga tre seksione:

- Pjesa rezidenciale e resortit, me vila elitare, vila individuale, vila twin dhe vila 4 familjare;
- Shëtitörja buzë detit e cila do të funksionojë si qendër argëtimi e biznesi;
- Hotel me 5 yje, i cili do të jetë një nga markat më të njohura botërore.

Të gjitha arsyet e mëposhtme e bëjnë këtë projekt **unik** në produktin që ofron, **destinacionin e preferuar** për këdo që dëshiron të ketë një shtëpi ëndrrash dhe garantojnë se **tani është koha më e mirë për të blerë një vilë në Green Coast, si një investim i sigurt, i zgjuar dhe me kthim të shpejtë.**

Green Coast është pjesë e grupit Balfin, grupi më i madh dhe inovator i investimeve në Shqipëri dhe një ndër më të mëdhenjtë në rajon, i njohur për investimet në qendrat tregtare QTU, TEG dhe SEG, zhvillimet e zonave rezidenciale dhe tregtare, në turizëm me projekte si Green Coast Resort dhe Vala Mar Residences, në industrinë e modës dhe atë minerare, si dhe në aktivitetet e shitjeve me pakicë me rrjetet e dyqaneve Neptun, Spar, Jumbo, etj.



ARKITEKTURË MODERNE E NDËRTHURUR ME STILIN TRADICIONAL



7 arsye thelbësore...

1. Vendodhja strategjike

Pozicionimi i Green Coast Resort në Palasë është një ndër avantazhet e këtij projekti, pasi është lehtësisht i aksesueshëm jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga rajoni dhe vendet fqinje. Vlora, qyteti më i afërt me Palasën, krahas portit do të ketë edhe një aeroport ndërkombëtar, i cili do ta lehtësojë aksesin. Gjithashtu, projekte të mëdha në infrastrukturën rrugore që tashmë janë miratuar nga qeveria, do ta shkurtojnë ndjeshëm distancën mes Palasës dhe zonave të tjera të vendit. Vendndodhja e resortit ofron mundësitë për të vizituar bukuritë natyrore të zonës e atraksionet e afërta historike dhe kulturore dhe për të ushtruar aktivitete të ndryshme sportive si: lundrimi, zhytja, rafting, parashutizmi apo eksplorimi i botës nënujore.

3. Investim i sigurt

Green Coast Resort po ndërtohet nga Grupi Balfin, grupi më i madh i investimeve jo vetëm në Shqipëri, por një ndër grupet më të fuqishme dhe më serioze në rajonin e Ballkanit. Green Coast është projekti më i madh dhe më i rëndësishëm i grupit në fushën e turizmit, me një vlerë investimi rreth 100 mil Euro.

2. Cilësi e lartë ndërtimi

Rëndësi shumë e madhe i jepet cilësisë së lartë të ndërtimit, konform modeleve dhe standardeve evropiane. Për projektimin e resortit është punuar me: A.N. Tombazis & Associates Architects, studio greke arkitekture dhe Iraci Architetti, studio italiane, studio të cilat kanë zhvilluar projekte në të gjithë botën dhe që në Green Coast sjellin eksperiencën e tyre më të mirë ndërkombëtare. Në formën e tij përfundimtare, resorti do të ketë shumë hapësira të gjelbërta në funksion të banorëve dhe vizitorëve, duke përdorur bimësi karakteristike të zonës. Gjithashtu avantazh për resortin përbën përmirësimi i infrastrukturës në shumë aspekte të saj siç janë sistemi i filtrimit të ujit të pijshëm, impianti i trajtimit të ujërave të zeza që synon kthimin e tyre në ujë për vaditje nëpërmjet teknologjisë më të fundit gjermane.

4. Rritja e vlerës së pronës në kohë

Bazuar në eksperiencën shumë vjeçare të grupit në fushën e pronave të patundshme dhe turizmit, parashikohet një rritje e çmimeve të pronave vit pas viti, gjë e cila e kombinuar edhe me zhvillimin që pritet të marrë zona, do të garantojë rritjen e vlerës së pronës suaj në pak vite dhe kthimin e shpejtë të investimit. Tani është koha e duhur për ta blerë këtë pronë, sepse më vonë vlera e saj do të rritet me shpejtësi.